1090
02.10.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 4678/1 Prot Elbasan më 02 /10/2025

**VENDIM**

Nr 112 datë 01 /10/2025.

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë pë muajin GUSHT 2025**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 23 datë 04.03.2025 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë"

**VENDOSI**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin GUSHT 2025, 77 familje me fond 237.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**

**Kryetar I Këshillit Bashkiak**
**Lutfi Lala**

**Miratuar datë** ___________
**Pro** ___________
**Kundër** ___________
**Abstenim** ___________

4678/2
06.10.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

**Nr.** 1090/1 **Prot** **Elbasan, më** 06.10.**2025**

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.112, datë 01.10.2025 "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Gusht 2025", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir Bejtja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Lgj.Brigada "17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel.0542138 prefektielbasan.gov.al, e-mail: prefekti.elbasan@mb.gov.al

1091
02.10.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 4679/1 Prot

Elbasan më 02 /10/ 2025

**VENDIM**

Nr. 113 datë 01 /10/2025

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin GUSHT 2025**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 24 datë 04.03.2025 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike"

**V E N D O S I**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara per muajin **GUSHT 2025** gjithsej 245 familje me një fond prej 1.170.927 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**

**Kryetar I Këshillit Bashkiak**
**Lutfi Lala**

**Miratuar datë** ___________
**Pro**___________
**Kundër**___________
**Abstenim**__________

4679/2
06.10.2025

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE**

**Nr.** 1231/1 **Prot** **Elbasan, më** 06.10**.2025**

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.113, datë 01.10.2025 "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Gusht 2025", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir Bejtja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

1052
02.10.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 4648/1 Prot.

Elbasan, 02.10.2025

**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

# V E N D I M

Nr. 114, datë 01.10.2025

## "PËR DHËNIEN E FONDIT PYJOR NË PËRDORIM" ANTENA TË TELEFONISË CELULARE

Këshilli bashkiak pasi shqyrtoj materialin e paraqitur nga administrata e bashkisë në lidhje me rinovimin e kontratave të qirasë ndërmjet operatorit telefonik "One Albania" sh.a dhe bashkisë Elbasan - *Për përdorimin e fondit pyjor publik të bashkisë*, në mbështetje të bazës ligjore të mëposhtëme:

a) Ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar;
b) Ligjit nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "*Për pyjet*", i ndryshuar;
c) Vendimit të Këshillit të Ministave nr. 433, datë 08.06.2016 "*Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike...*", i ndryshuar;
d) Vendimit të Këshillit të Ministave nr.559, datë 29.07.2022 "*Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore*", i ndryshuar;
e) Udhëzimit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr.1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".

## V E N D O S I

1. Të miratoj rinovimin e kontratave të qirasë për përdorimin e fondit pyjor publik me kode "*Shmil 1268*" dhe "*Zavalinë 1246*", me afat 9 (*nëntë*) vjeçar nga lidhja e kontratës.
2. Pagesat vjetore për përdorimin e fondit pyjor do të jenë sipas VKM nr.559, datë 29.07.2022 "*Për çmimet dhe tarifat e përdorimit të fondit pyjor*", shtojca nr.1, pika 7, i ndryshuar, (*tabela përllogaritëse bashkëlidhur këtij vendimi)*.
3. Drejtoria e Pyjeve dhe Bujqësisë ngarkohet për ndjekjen e të gjithë procedurave administrative me qëllim finalizimin e lidhjes së kontratave të qirase dhe vjeljen e të ardhurave përkastëse.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (*sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"*).

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**

**KRYETAR**
**Lutfi Lala**

*Konc. Xh. Muça*
*Pranoi: J. Bodurri*
*Miratoi: K. Gripshi*

Miratuar me ________vota
Vota Pro______
Vota Kundër_______
Vota Abstenim__________
Zbardhur me datë ____/____/2025

**BASHKIA ELBASAN**
**AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE**
DREJTORIA E PYJEVE DHE BUJQËSISË

# PËRMBLEDHËSE
# PËR DHËNIEN E FONDIT PYJOR NË PËRDORIM
**"Për vendosjen e antenave telefonike të lëvizëshme"**

| Nr. | Ngastra | Ekonomi a pyjore | Përdorimi territorit | Qëllimi i dhënies në përdorim | Tarifat përkatëse për dhënien në përdorim | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Ha | Lekë/ha/vit | Rrugë lidhëse (Km) | Lekë/ km/vit | Totali (Lekë) |
| 1. | 98/c | Shmil | Inproduktive | Për vendosje antene telefonike të lëvizëshme | 0,0205 | 5,000,000 | 0,15 | 25,000 | 106,250 |
| 2. | 101/a | Gjinar-Zavalinë | Pyll Trungishte | | 0,022 | 10,000,000 | 0 | 0 | 220,000 |
| TOTALI: | | | | | 0,0425 | | 0,15 | | 326,250 |

**Specialisti i Kadastrës** — Xhulian Muça

**Pergj. Sekt. Menaxhimit dhe Mbrojtjes** — Jakov Bodurri

**D R E J T O R I** — Klajd Gripshi

4648/2
06.10.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN**

Nr. 1092/1 prot.

Elbasan, më 06.10.2025

Lënda: Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj nr.114 datë 01.10.2025 "Për dhënien e fondit pyjor në përdorim, për antena të telefonisë celulare", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

1093
02.10.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 4470/1 Prot.

Elbasan, 02.10.2025

**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

# VENDIM

Nr. 115, datë 01.10.2025

## PËR MIRATIMIN E SHPALLJES SË ZONAVE PRIORITARE TË ZHVILLIMIT NË TERRITORIN E BASHKISË ELBASAN

Këshimi Bashkiak pasi shqyrtoj materialin e paraqitur nga Grupi i Punës për identifikimin dhe shpalljen e zonave prioritare të zhvillimit, brenda territorit administrativ të Bashkisë Elbasan, në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligjit nr. 20/2025 "Për Paketën e Maleve"; Udhëzimit nr.1, datë 19.06.2025 "*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në territoret e Bashkive*"; Urdhërit nr. 454, datë 27.06.2025 "*Për ngritjen e grupit të punës për identifikimin e zonave me përparësi zhvillimi*".

**VENDOSI**

1. Të miratoj Zonat prioritare të zhvillimit, Nj. Adm. Gjinar, Funar, Tregan dhe Shushicë në zbatim të ligjit nr. 20/2025 "Për Paketën e Maleve".
2. Bashkia Elbasan të përcjellë të gjithë dokumentacionin përkatës pranë Ministrisë së Pushtetit Vendor për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (*sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore"*).

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**

**KRYETAR**
**Lutfi Lala**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

*Konceptoi: Grupi Punës*
*A. Sula*
*P. Lamçja*
*H. Idrizi*
*Xh. Muça*
*E. Krraba*
*E. Doko*
*G. Kerri*
*K. Totoshi*

Miratuar me ______________vota
Vota Pro ________________vota
Vota Kundër______________vota
Vota Abstenim____________vota
Zbardhur me datë ____/____ 2025

Adresa: Bashkia Elbasan Rruga "11 Nëntori", Tel. +355 54 400152, E-mail bashkiaelbasa@elbasani.gov.al

4770/2
08.10.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 1273/1 prot. Elbasan, më 09/10.2025

Lënda: Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr. 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.115 datë 01.10.2025 "Për miratimin e shpalljes së zonave prioritare të zhvillimit në territorin e Bashkisë Elbasan", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

1055
02.10.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 4682/1 Prot

Elbasan. 02.10.2025

**VENDIM**

**Nr.117 Datë 01/10/2025**

**"PËR MIRATIMIN E PËR TRANSFERIMIN E AUTOMJETIT "AUTOVETURË ID.7 PRO 210KW ,NGA AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE NË AGJENCINË E SHËRBIMEVE PUBLIKE URBANE**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54, të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Këshilli i Bashkisë Elbasan, pasi mori në shqyrtim Relacionin e paraqitur nga Agjensia e Shërbimeve Publike Rurale Elbasan, Nr._____ Prot. Datë _________ në mbledhjen e tij të datës ___/ __ /___

**VENDOSI:**

**1-**Të miratojë transferimin e automjetit ,nga Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale në Agjencinë e Shërbimeve Publike Urbane sipas përcaktimeve:

| Nr | Pershkrimi | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlera | Viti vënies në punë | Amortizimi Akumuluar | Vlera e mbetur |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Autoveturë ID.7 PRO 210KW AB802VF LFVVA9EA0R5353386 | copë | 1 | 3,400,000 | 3,400,000 | 27,08,2025 | 0 | 3 400 000 |

**2.** Agjensia e Shërbimeve Publike Urbane Elbasan, në zbatim të udhëzimit nr.30 dt.27.11.2011 pika 108: Të dërgojë një Konfirmimi zyrtar ,që vërteton përfundimin e transaksionit,Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale .

**3.** Ngarkohen Drejtorët e Agjensisë së Shërbimeve Publike Rurale dhe Agjensia e Shërbimeve Publike Urbane,Bashkia Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

**5-**Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

Konc.P.Sektori mekanikës Gazmend Gaxhja
Kocp.P.finc.Burbuqe Dedja
Pranoi:Drejtori Altin CENOLLI

**SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**LUTFI LALA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN -

4682/2
06.10.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 1295/1 Prot                                                                 Elbasan, më 06.10.2025

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.117 datë 01.10.2025 "Për miratimin e për transferimin e automjetit "Autoveturë ID.7 PRO 210 KW" nga ASHPR në ASHPU", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**
**Ilir Bejtja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

1096
02.10.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 4681/1 Prot.

Elbasan. 02. 10. 2025

# VENDIM

**Nr. 118 Datë 01/10/2025**

**"PËR**
**MIRATIMIN E TRANSFERIMIN E AUTOMJETEVE NGA ASHPR NË AGJENCINË E MBIKQYRJES DHE KONTROLLIT**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54, të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Këshilli i Bashkisë Elbasan, pasi mori në shqyrtim Relacionin e paraqitur nga Agjensia e Shërbimeve Publike Rurale Elbasan, Nr._____ Prot. Datë _________ në mbledhjen e tij të datës ___/ __ /___

**VENDOSI:**

**1-**Të miratojë transferimin e automjeteve ,nga Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale në Agjencinë e Mbikqyrjes dhe Kontrollit sipas përcaktimeve:

**1-Automjete në përdorim të Policisë Bashkiake në varësi të Agjencisë së Mbikqyrjes dhe Kontrollit**

| Nr | Pershkrimi | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlera | Viti vënies në punë | Amortizimi Akumuluar | Vlera me 31.12.2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Automjet volsvagen Wvtzzz2hzih020823Vw Amarok targa AB536DF | Copë | 1 | 4.540.000 | **4,540,000** | 08.06.2021 | 2,897,367 | 1,642,633 |
| 2 | Automjet Knadb518am6559645 Kia Rio targa AB560DF | Copë | 1 | 2.214.000 | **2,214,000** | 08.06.2021 | 1,412,945 | 801,055 |

**2-Automjete në përdorim të IKMT në varësi të Agjencisë së Mbikqyrjes dhe Kontrollit**

| Nr | Pershkrimi | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlera | Viti vënies në punë | Amortizimi Akumuluar | Vlera me 31.12.2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Mitsubishi Pajero JMPONH77WIX008424 targa AB711OC | cope | 1 | 982,800 | **982,800** | 2001 | 982 800 | 0 |

**3-Automjete elektrike në përdorim të Agjencisë së Mbikqyrjes dhe Kontrollit**

| Nr | Pershkrimi | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlera | Viti vënies në punë | Amortizimi Akumuluar | Vlera me 31.12.2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Autoveturë BYD BYD6433SBEV2 Targa AB778VF Shasia: LCOCE4CB9S4144599 | Copë | 1 | 2,000,000 | **2,000,000** | 27.08.2025 | 0 | 2,000,000 |
| 2 | Autoveturë BYD BYD6433SBEV2 targa AB784VF Shasia: LC0CE4CB4S415332 | Copë | 1 | 2,000,000 | **2,000,000** | 27.08.2025 | 0 | 2,000,000 |
| 3 | Autoveturë BYD BYD6433SBEV2 Targa AB 814VF Shasia: LC0CE4CB6S417342 | Copë | 1 | 2,000,000 | **2,000,000** | 27.08.2025 | 0 | 2,000,000 |

**2.** Agjensia e Mbikqyrjes dhe Kontrollit Elbasan, në zbatim të udhëzimit nr.30 dt.27.11.2011 pika 108: Të dërgojë një Konfirmimi zyrtar ,që vërteton përfundimin e transaksionit,Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale .

**3.** Ngarkohen Drejtorët e Agjensisë së Shërbimeve Publike Rurale dhe Agjensisë së Mbikqyrjes dhe Kontrollit,Bashkia Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

**5**-Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

Konc.P.Sektori mekanikës Gazmend Gaxhja
Kocp.P.finc.Burbuqe Dedja
Pranoi:Drejtori Altin CENOLLI

**SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK** **KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**LUTFI LALA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

4681/2
06.10.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 1096/1 Prot

Elbasan, më 06.10.2025

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.118 datë 01.10.2025 "Për miratimin e transferimin e automjeteve nga ASHPR në Agjencinë e Mbikqyrjes dhe Kontrollit", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir Bejtja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

1097
02.12.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 4708/1. Prot

Elbasan. 02.10.2025

## VENDIM

**Nr. 118 Datë 01/10/2025**

**"Për miratimin e transferimit të automjetit "Autoveture e Re Elektrik VW ID4 LFVVB9E66P5006604 me targa AB645PX "nga ASHPU në ASHPR.**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54, të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Këshilli i Bashkisë Elbasan, pasi mori në shqyrtim Relacionin e paraqitur nga Agjensia e Shërbimeve Publike Urbane Elbasan, Nr. Prot. Datë ______ në mbledhjen e tij të datës ___/__/___

## VENDOSI:

**1.**Të miratojë transferimin e automjetit "**Autoveture e Re Elektrik VW ID4 LFVVB9E66P5006604 me targa AB645PX** ",nga Agjencia e Shërbimeve Publike Urbane në Agjencinë e Shërbimeve Publike Rurale sipas përcaktimeve:

| Nr | Pershkrimi | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlera | Viti vënies në punë | Amortizimi Akumuluar | Vlera me 31.12.2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Autoveture e Re Elektrik VW ID4 LFVVB9E66P5006604 AB645PX | copë | 1 | 3,000,000 | 3,000,000 | 18.9.2024 | 250,000 | 2,750,000 |

**2.** Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale Elbasan, në zbatim të udhëzimit nr.30 dt.27.11.2011 pika 108: Të dërgojë një Konfirmimi zyrtar ,që vërteton përfundimin e transaksionit,Agjencisë së Shërbimeve Publike Urbane .

3. Ngarkohen Drejtorët e Agjensisë së Shërbimeve Publike Rurale dhe Urbane Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

4.Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

Konc.P.Sektori teknik dhe mekanik Erind Osmani

Kocp.spec.finc. Loreta Tutulaku

Pranoi:Drejtori Gezim Keci

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**

**Lutfi Lala**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN -

4709/2
06.10.2025

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE**

**Nr.** 1037/1 **Prot** **Elbasan, më** 06.10**.2025**

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.119 datë 01.10.2025 "Për miratimin e transferimit të automjetit "Autoveturë e re elektrik VW ID4LFVVB9E66P50006604 me targa AB645PX" nga ASHPU në ASHPR", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**
**Ilir Bejtja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

1098
02.10.2025

**REPUBLIKA E SHQIPERISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr.** 4773/1 **Prot.** **Datë** 02 **.10. 2025**

# VENDIM

**NR.** 120 **DATË** 01 **.** 10 **2025**

**MBI**

**"Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e dytë, të vitit 2025"**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.09.2025, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi **"Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e dytë të vitit 2025"**, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërise", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 48, pika 1, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.22, date 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore",

**VENDOSI :**

1. Të miratoje "Raportin e monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e dytë, të vitit 2025 (progresiv janar-gusht)", për Bashkinë Elbasan, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

**KRYETARI**
**Lutfi Lala**

P.Sekt.Buxhetit: M.Behluli
Dr.Buxhet Fin.: A.Merkja
D.P.Sh.M: S. Mehmeti
D.P.K.S.A.R.S : D.Rroseni
D.P.M.C.M.B.P.K : Sh. Çullhaj
Dr.Juridike: A.Hoxha
Zv/kryetar : K. Krasnika

4772/2
06.10.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

**Nr.** 10981/1 **Prot** **Elbasan, më** 06.10.2025

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.120 datë 01.10.2025 "Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e dytë, të vitit 2025", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKT-REPUBLIKA E SHQIPËRISË PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

**PREFEKTI**
**Ilir Bejtja**

Lgj.Brigada "17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel.0542138 prefektielbasan.gov.al, e-mail: prefekti.elbasan@mb.gov.al

1039
02.10.2025

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4774/1 Prot. Datë 02.10. 2025

**VENDIM**

**NR. 121, DATË 01.10. 2025**

**MBI**

**"MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028, FAZA E DYTË"**

Këshilli Bashkiak i Qytetit Elbasan, i mbledhur sot më datë ____ .09.2025, pasi mori në shqyrtim materialet e përgatitura nga Bashkia e Qytetit Elbasan, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, "Mbi miratimin e fazës së dytë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028", mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërise", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", si dhe Udhëzimin nr.8, datë 28.02.2025 të Ministrisë së Financave dhe Udhëzimin Plotësues nr.19, datë 10.07.2025 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028",

**VENDOSI :**

1. Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, të rishikuar (faza e dytë), për Bashkinë Elbasan, sipas materialit bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI**
**Lutfi Lala**

| | |
|---|---|
| P/Sekt.Buxhetit : | M.Behluli |
| Dr.Buxh.Fin.: | A.Merkja |
| D.P.Sh.M : | S. Mehmeti |
| D.P. K.S.A.R.S : | D. Rroseni |
| D.P.M.C.M.B.P.K : | Sh. Çullhaj |
| Dr.Juridike: | A.Hoxha |
| Zv/kryetar : | K. Krasnika |

4774/2
06.10.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 1299/1 Prot	Elbasan, më 06.10.2025

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.121 datë 01.10.2025 "Miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028, faza e dytë", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

**PREFEKTI**

**Ilir Bejtja**

Lgj.Brigada "17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel.0542138 prefektielbasan.gov.al, e-mail: prefekti.elbasan@mb.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4832/1 Prot. Datë 02 .10. 2025

# VENDIM

NR. 122 DATE 01 . 10. 2025

MBI

**"Transferim fonde në buxhetin e vitit 2025 dhe periudhën afatmesme 2026-2028",**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ .10.2025, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi **"Transferim fonde për investime në buxhetin e vitit 2025, dhe periudhën afatmesme 2026-2028"**, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", "Udhëzimin plotësues nr.2, datë 24.01.2025 të Ministrisë së Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025" dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.138, datë 26.12.2024, për "Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan dhe Këshillit Bashkiak për vitin 2025, si dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027", i ndryshuar,

## VENDOSI

1. Transferimin e fondeve në buxhetin e vitit 2025 dhe periudhën afatmesme 2026-2028, grant dhe të ardhura, njësia shpenzuese Bashkia dhe insitucionet vartëse, për financimin e objekteve për investime dhe shpenzimeve, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Buxhetit, Drejtoria e Prokurimeve dhe institucionet vartëse.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

KRYETARI
Lutfi Lala

P/Sekt.Buxhetit : M.Beluli
Dr.Buxh.Fin. : A.Merkja
Dr.Juridike: A.Hoxha

**<u>"Transferim fonde në buxhetin e vitit 2025 dhe periudhën afatmesme 2026-2028",</u>**

***PAKSIME :***

ne leke

| Gr | Progr. | Funks. | Produk. | Kap | Art | Kodi instit. | Institucioni | Shuma/2025 | 2026 | 2027 | 2028 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 00 | AC109 | 04520 | V452AAB | 5 | 602 | Shpenzime rrugët rurale | *ASHPR* | 1,960,000 | | | |
| 00 | AE109 | 06260 | V626AAF | 5 | 602 | Shpenzime mekanikë dhe mirëmbajtje | *ASHPR* | 1,040,000 | | | |
| 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 5 | 231 | Ndërtimi i dy segmenteve paralele në Bulevardin "Aqif Pasha", PDV 1/27", me 3 vite financim, 2025-2027 (vlera e projektt 64,550,000 lekë) | ***ASHPU*** | 16,137,500 | 20,412,500 | 28,000,000 | |
| 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 5 | 231 | "Rehabilitimi i sheshit te pallateve 583 Lagj. " Visarion Xhuvani" (tep. prok) | ***ASHPU*** | 6,362,500 | | | |
| 00 | ACF09 | 08220 | V822AAC | 5 | 231 | Arredimi i brendshëm muzeal në Muzeun e shkollës "Normale" dhe Muzeun" Aleksandër Xhuvani" | ***DPKS*** | 10,000,000 | | | |
| 00 | AH109 | 10430 | V043AAF | 5 | 231 | Rikonstruksion i çerdhes nr.2 në qytetin e Elbasanit (në bashkëfinancim me Raiffeisen INVEST Sh.A) (tep. prok.) | ***D.P.Arsimit*** | 3,000,000 | | | |
| 00 | AA109 | 01710 | V171AAB | 5 | 166 | Kredia principal (teprice fondi) | ***A.SH.Soc.*** | 5,000,000 | | | |
| 00 | AF109 | 08130 | V813AAB | 5 | 604 | "Projekte për Rinine" | ***DPKS*** | 2,800,000 | | | |
| 00 | AE109 | 06260 | V626AAF | 1 | 602 | Shpenzime mirëmbajtje terrene sportive | ***ASHPR*** | 120,000 | | | |
| 00 | AA109 | 01710 | V171AAB | 5 | 166 | Kredia rincipal (teprice fondi, kredia e pa disbursuar) | ***Bashkia*** | 1,100,000 | | | |
| 00 | AA109 | 01710 | V171AAB | 5 | 651 | Kredia interesa (teprice fondi, kredia e pa disbursuar) | ***Bashkia*** | 2,000,000 | | | |
| | | | | | | | | **49,520,000** | **20,412,500** | **28,000,000** | |

***SHTESA:***

ne leke

| Gr | Progr. | Funks. | Produk. | Kap | Art | Kodi instit. | Institucioni | Shuma/2025 | 2026 | 2027 | *2028* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 00 | AG109 | 09230 | V923AAB | 5 | 231 | Mobilim i ambienteve ndihmese te aktiviteteve sportive per grupmoshat e nxenesve te qytetit, Lagj. "Q.Stafa" | ***D.P.Arsimit*** | 3,000,000 | | | |
| 00 | AF109 | 08220 | V822AAC | 5 | 231 | Vendosje kondicionerë dhe arredim me stenda ekspozimi, etj, të "Infopoint & Muzeut të Shpatit" | ***DPKS*** | 1,500,000 | | | |
| 00 | AE109 | 06440 | V644AAB | 5 | 231 | Përmirësim i ndriçimit të bulevardit "Aqif Pasha" Elbasan | ***ASHPU*** | 9,000,000 | | | |
| 00 | AH109 | 10430 | P043AAF | **5** | 231 | Mobilim i çerdhes Nr.5, në lagjen "Kongresi i Elbasanit", | ***D.P.Arsimit*** | 16,500,000 | | | |
| 00 | AC109 | 04520 | V452AAC | 5 | 231 | Ndërtimi i dy segmenteve paralele në Bulevardin "Aqif Pasha", PDV 1/27", me 3 vite financim, 2025-2027 (vlera e projektt 64,550,000 leke) | ***ASHPU*** | | 16,137,500 | 20,412,500 | 28,000,000 |
| 00 | AE109 | 06440 | A644AAC | 5 | 602 | Shpenzime ndiçim rrugor (energji elektrike) | ***ASHPR*** | 5,000,000 | | | |
| 00 | AE109 | 06260 | V626AAF | 1 | 231 | Blerje motokorrese plus aksesorë | ***ASHPR*** | 120,000 | | | |
| 00 | AB109 | 03280 | V328AAC | 5 | 602 | Shpenzime ujë SHMZSH | ***AMK*** | 400,000 | | | |
| 00 | AA109 | 01110 | V111AAD | 5 | 602 | Shpenzime energji elektrike | ***Bashkia*** | 3,000,000 | | | |
| 00 | AA109 | 01110 | V111AAD | 5 | 602 | Shpenzime komisione poste (nd.ek) | ***Bashkia*** | 5,000,000 | | | |
| 00 | AA109 | 01110 | V111AAD | 5 | 602 | Shpenzime udhëtim e dietë (jasht vendit) | ***Bashkia*** | 700,000 | | | |
| 00 | AA109 | 01110 | V111AAA | 5 | 602 | Kryetarë fshatrash | ***Bashkia*** | 200,000 | | | |
| 00 | AA109 | 01110 | V111AAA | 5 | 602 | Ndërlidhësa | ***Bashkia*** | 200,000 | | | |
| 00 | AA109 | 01110 | V111AAD | 5 | 602 | Tarifë për oponencën e projekteve në investime | ***Bashkia*** | 600,000 | | | |
| 00 | AE109 | 06260 | V626AAF | 5 | 602 | Shpenzime ujë | ***ASHPU*** | 2,200,000 | | | |
| 00 | AE109 | 06260 | V626AAB | 5 | 602 | Mirëmbajtje Varreza Publike (blerje pllaka varri) | ***ASHPU*** | 500,000 | | | |
| 00 | AF109 | 08130 | V813AAB | 5 | 602 | Shpenzime për sportistet e huaj | ***DPKS*** | 1,000,000 | | | |
| 00 | AF109 | 08230 | V823AAB | 5 | 231 | Blerje kondicionerë për "Teatrin e Kukullave" | ***DPKS*** | 300,000 | | | |
| 00 | AF109 | 08220 | V822AAC | 5 | 231 | Blerje e dy kostumeve popullore (me të gjithë pjesët) të zonës së Shpatit (një kostum burrash dhe një kostum grash) | ***DPKS*** | 250,000 | | | |
| 00 | AF109 | 08220 | V822AAC | 5 | 231 | Blerje e objekteve muzeale (kashtur rakie, shtambë balte, djep, furkë leshi, krehër, gjym, tezgjah i madh për endje, etj.) | ***DPKS*** | 50,000 | | | |
| | | | | | | **Totali :** | | **49,520,000** | **16,137,500** | **20,412,500** | **28,000,000** |

4832 /2
08. 10. 2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 1100/1 Prot

Elbasan, më 9.10.2025

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.122 datë 01.10.2025 "Për transferim fondesh në buxhetin e vitit 2025 dhe periudhën afatmesme 2026-2028", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir Bejtja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Lgj.Brigada "17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel.0542138 prefektielbasan.gov.al, e-mail: prefekti.elbasan@mb.gov.al

1101
02.10.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E BUXHET-FINANCËS

Nr. 4772/1 Prot. Elbasan më 02.10.2025

# VENDIM

NR. 123, DATË 01.10. 2025

## MBI

**"Transferimin e aseteve, debitorëve, kreditorëve nga Bashkia Elbasan në Agjencinë e Mbikqyrjes dhe Kontrollit dhe në Agjencinë e Shërbimeve Publike Urbane"**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.7661, datë 19.01.1993 "Për kontabilitetin", V.K.M. Nr.248, datë 10.04.1998 "Për kontabilitetin e institucioneve buxhetore dhe ndërmarrjeve shtetërore", Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", VKB Nr.141, datë 26.12.2024 "Miratimin e riorganizimit të njësive operative vartëse të bashkisë dhe numrit maksimal të punonjësve të tyre dhe të aparatit të administratës të Bashkisë Elbasan për vitin 2025", pasi mori në shqyrtim materialet për transferimin e aseteve, debitorëve dhe kreditorëve nga institucioni i Bashkisë Elbasan në Agjencinë e Mbikqyrjes dhe Kontrollit dhe Agjencinë e Shërbimeve Publike Urbane, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Elbasan

## VENDOSI

1. Të miratojë transferimin e aseteve, debitorëve dhe kreditorëve nga institucioni i Bashkisë Elbasan në Agjencinë e Mbikqyrjes dhe Kontrollit dhe Agjencinë e Shërbimeve Publike Urbane si më poshtë dhe sipas pasqyrave e materialeve bashkëlidhur :

Adresa: Bashkia Elbasan, Rruga "Qemal Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

Transferimet sipas llogarive ekonomike të aseteve nga institucioni i Bashkisë Elbasan në Agjencinë e Mbikqyrjes dhe Kontrollit:

| Nr | Llogaria Ekonomike | Vlera | Institucioni ku transferohen |
|---|---|---|---|
| 1 | 212 | 6,635,436 | Agjencia e Mbikqyrjes dhe Kontrollit |
| 2 | 214 | 13,111,699 | Agjencia e Mbikqyrjes dhe Kontrollit |
| 3 | 215 | 22,301,086 | Agjencia e Mbikqyrjes dhe Kontrollit |
| 4 | 218 | 2,397,226 | Agjencia e Mbikqyrjes dhe Kontrollit |
| 5 | 327 | 11,985,876.136 | Agjencia e Mbikqyrjes dhe Kontrollit |
| | **Shuma** | **56,431,323.136** | |

| Nr | Përshkrimi | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Debitorët | 1,151,750 |
| 2 | Kreditorët | 30,900 |
| | **Shuma** | **1,182,650** |

Transferimet sipas llogarive ekonomike të aseteve nga institucioni i Bashkisë Elbasan në Agjencinë e Shërbimeve Publike Urbane:

| Nr | Llogaria Ekonomike | Vlera | Institucioni ku transferohen |
|---|---|---|---|
| 1 | 214 | 119,000 | ASHPU |
| 2 | 218 | 97,766 | ASHPU |
| 3 | 327 | 24,100 | ASHPU |
| | **Shuma** | **240,866** | |

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**

**Lutfi Lala**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

4772/1
06.10.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

**Nr. 1101/1 Prot** **Elbasan, më 06.10.2025**

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.123 datë 01.10.2025 "Transferimin e aseteve, debitoreve, kreditoreve nga Bashkia Elbasan në Agjencinë e Mbikqyrjes dhe Kontrollit dhe në Agjencinë e Shërbimeve Publike Urbane", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir Bejtja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Lgj.Brigada "17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel.0542138 prefektielbasan.gov.al, e-mail: prefekti.elbasan@mb.gov.al

1122
02.10.2025

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

*Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

Nr. 4793/1 Prot. Elbasan më, 02.10.2025

**VENDIM**

**Nr. 124 Datë 01.10.2025**

**Për ndryshimin e VKB Elbasan nr. 76 datë 01.07.2025**

**"Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2025"**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenit 65 të ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile", VKM nr. 414 datë 8.7.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kritereve për përdorimin dhe shpërndarjen e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile"; VKB nr. 138 datë 26.12.2024, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2025, si dhe Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2025-2027", si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile:

**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDOSI**

1. Miratimin e rishpërndarjes së fondit të Mbrojtjes Civile për vitin 2025 prej 7,196,200 lekë parashikuar për tu përdorur në zërat e pakësuara dhe shtimin e një objekti të ri emergjent:

**PAKËSOHET**

| | | |
|---|---|---|
| 5,433,841 | lekë | Kompesime të demeve te shkaktuara nga fatkeqësite natyrore |
| 712,793 | lekë | Ndertim shkalle metalike ne pallatin nr.42 ,Rruga Serafin Jorgaqi, Lagjja Shenkoll. |
| 707,166 | lekë | Shpenzime per mbajtjen ne gadishmeri te kalueshmerise se mjeteve zjarrfikes ne rruge pyjore (blerje karburanti) |
| 150,000 | lekë | Shpenzime operative per perballimin e ngjarjeve dhe situatave te emergjences civile. |
| 6,000 | lekë | Tepricë nga likujdimi i detyrimeve të prapambetura |
| 186,400 | lekë | Tepricë nga Blerje pajisje ndihmese per fikjen e zjarrit + helmeta per MZSH-në |

**7,196,200 lekë gjithsej**

**SHTOHET**

**7,196,200** lekë "Ndërtimi i këmbëve dhe speronave të urës tip beli mbi përroin Lugaj, në fshatin Labinot Katund të Njësisë Administrative Labinot Mal" (financim pjesor nga fondi i Ministrisë së Mbrojtjes 2025)

2. Përdorimin e fondit të Emergjencave Civile nga buxheti i Bashkisë Elbasan miratuar me VKB nr. 138 datë 26.12.2024, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2025, si dhe Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2025-2027", si më poshtë:

**PAKËSOHET**

**4,548,607** lekë Fondi i Emergjencave Civile

**SHTOHET**

| | | |
|---|---|---|
| 3,515,539 | lekë | "Ndërtimi i këmbëve dhe speronave të urës tip beli mbi përroin Lugaj, në fshatin Labinot Katund të Njësisë Administrative Labinot Mal" (diferencë financimi) |
| 278,505 | lekë | Supervizim |
| 41,770 | lekë | Kolaudim |
| 712,793 | lekë | Ndërtim shkalle metalike në pallatin nr. 42 , Rruga Serafin Jorgaqi, Lagjja Shenkoll. |

**4,548,607 lekë**

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Prokurimeve dhe Drejtoria e Emergjencave Civile.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Lutfi Lala**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

| | | | |
|---|---|---|---|
| Drejtori MC | N. Sinani | Dr. Juridike | A. Hoxha |
| Dr. Buxhet Financë | A. Merkja | Zv/Kryetari | K.Krasnika |

4799/2
05.10.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Nr. 1102/1 Prot. Elbasan, më 09.10.2025

Lënda: Konfirmim Akti.

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Adresa:Lagjja " Br.17 Sulmuese", Rruga " Qemal Stafa"

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.124 datë 01.10.2025, Për ndryshimin e VKB Elbasan nr.76 datë 01.07.2025 " Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2025 ", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 4780/1 Prot. Elbasan, më: 02 .10.2025.

**V E N D I M**

**Nr. 126 Datë: 01 .10.2025.**

***"Marrje me qira (rinovim kontrate) ambjent (strehëz emergjence) për Forumin e Gruas Elbasan".***

Bazuar në ligjin nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, i ndryshuar, ligjin Nr. 7850 datë 29.07.1994 *"Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar, ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, *"Për masa ndaj dhunës për marrdhëniet familjare"*, i ndryshuar, V.K.M nr. 327 datë 02.06.2021 *"Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjës për referimin e rasteve të dhunës në marrdhëniet familjare si dhe proçedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës"*, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës____.09.2025, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Pronave Publike dhe Strehimit, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Përgjithshme e Kujdesit Social, Arsimit dhe Rinisë i relaton Këshillit Bashkiak, *"Marrje me qira (rinovim kontrate) ambjent (strehëz emergjence) për Forumin e Gruas Elbasan"*;

**V E N D O S I :**

1. Miratimin marrje me qira ambjentin me sipërfaqe 98,5 m$^2$, ndodhur në Z.K. 8525, Lagja *"5 Maj"*, për periudhën 1 (një) vjeçare nga 15.09.2025 deri 14.09.2026, me vlerë qiramarrje prej 23000 lekë/muaj, për t'a përdorur (strehëz emergjence) për Forumin e Gruas Elbasan.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Pronave Publike dhe Strehimit, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Përgjithshme e Kujdesit Social, Arsimit dhe Rinisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI**
**Lutfi Lala**

**SEKRETARI**

*Konceptoi: G. Kerri* *A. Pisha*
*Drejtoria P.P.S :* *A. Suli*
*Drejtoria B.F:* *A. Merkja*
*Drejtoria P.Sh.M:* *S.Mehmeti*
*Drejtoria P.K.S.A.R:* *D. Roseni*
*Drejtoria J. I:* *A. Hoxha*
*Zv/Kryetari:* *K. Krasnika*

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

Miratuar me ______ vota

Vota Pro _____

Vota kundër _____

Vota Abstenim_____

Zbardhur më datë_____/_____/2025

4798/2
08.10.2025

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI JURIDIK**

**Nr.** 1104/1 **Prot.** **Elbasan më** 08/10. **2025**

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.126 datë 01.10.2025 "Marrje me qira (rinovim kontrate) ambient (strehëz emergjence) për Forumin e Gruas Elbasan", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ilir BEJTJA**

PREFEKTI I QARKUT ELBASAN - REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Lgj "Brigada 17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel 054 252138, www.prefekti.elbasan.gov.al , email: prefekti.elbasan@mb.gov.al